



Misioni dhe fushëveprimi i Presidencës së Republikës së Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës udhëheq Presidencën e Republikës së Kosovës dhe ushtron kompetencat në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Presidenca është selia e aktivitetit zyrtar të Presidentes, që përfshin Kabinetin e Presidentes, Zyrën e Presidentes dhe institucionet/njësitet tjera të ndërlidhura. Kabineti i Presidentes, përbëhet nga Këshilltarët e Presidentes dhe nëpunësit e Kabinetit. Zyra e Presidentes është njësi organizative e Presidencës dhe institucion i veçantë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës, ndërsa institucionet/njësitet tjera të ndërlidhura janë ato të cilat janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet ndërmjet të gjitha këtyre strukturave organizative të Presidencës janë marrëdhënie bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me mision për mbështetjen e Presidentes në kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të përcaktuara me Kushtetutë, ligje, si dhe me legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.

Fushëveprimi i Presidencës është i ndërlidhur me kompetencat që i janë akorduar me Kushtetutë dhe me ligje të veçanta me ligjet në fuqi. Në këtë drejtim, Presidentja, në cilësinë e kreut të shtetit, përfaqësueses së unitetit të popullit, përfaqësueses legjitime të vendit brenda dhe jashtë dhe garantueses të funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, ushtron edhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- (1) është Komandante Supreme e Forcave të Sigurisë së Kosovës;
- (2) është një nga hallkat e zinxhirit të kontrollit civil dhe mbikëqyrjes demokratike të FSK-së, siç është përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligjet tjera përkatëse;
- (3) udhëheq politikën e jashtme të vendit dhe Kryeministri këshillohet me Presidenten për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;
- (4) cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës (Kuvendin), pas konsultimit me partitë politike;

- (5) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës (Qeverisë), pas zgjedhjeve, apo nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i saj mbetet i lirë, sipas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- (6) thërret mbledhjen/seancën e parë të Kuvendit;
- (7) cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve lokale, pas konsultimit me partitë politike;
- (8) mund të bëjë kërkesë për mbajtjen e mbledhjeve të mbyllura dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit, në rastet e përcaktuara me Rregulloren e Punës të Kuvendit;
- (9) bën zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit (deputetëve) në rastet kur një ulësë të mbetet e zbrazët, pas kërkesës me shkrim nga Kryetari i Kuvendit, dhe sipas emrit të radhës që ofrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- (10) mund të shpërndajë Kuvendin, në rast të përmbushjes së ndonjëres nga rrethanat e përcaktuara në nenin 82 të Kushtetutës;
- (11) mund të propozojë ndryshime dhe amendamente të Kushtetutës;
- (12) ka të drejtë për të propozuar ligje nga fushë veprimtaria e saj sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin për nisma legislative;
- (13) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi;
- (14) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara në Kuvend, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- (15) ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare të cilat nuk ratifikohen në Kuvend;
- (16) ka autoritet për kryerjen e të gjitha veprimeve të ndërlidhura dhe për të nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet e aderimit në konventat ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës si dhe njofton Kuvendin për nënshkrimin e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare;
- (17) pas rekomandimit nga Qeveria, autorizon kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, për këto çështje: territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; të drejtat dhe liritë fundamentale; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare, si dhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës;
- (18) pas rekomandimit të ministrisë ose agjencisë shtetërore, kompetencë e së cilës është hartimi i marrëveshjes ndërkombëtare, autorizon lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit, me kusht që Ministria e Punëve të Jashtme të ketë dhënë pëlqimin paraprak për marrëveshjen përkatëse;
- (19) ka të drejtë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (20) ka nën autoritetin e saj Këshillin Konsultativ për Komunitete, dhe në këtë drejtim emëron anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe kryeson dy herë në vit

- takimet e tij, për ta bërë një shqyrtim të përgjithshëm të politikave dhe shqetësimeve të komuniteteve në Republikën e Kosovës;
- (21) emëron, gradon, shkarkon dhe liron nga detyra Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pas rekomandimit nga Kryeministri;
 - (22) ka kompetencë që të bëjë gradimet, emërimet, ndryshimet, shkarkimet dhe lirimet nga detyra në gradën e Gjeneralit, sipas propozimit të Ministrit të Mbrojtjes, në konsultim me Kryeministrin dhe sipas rekomandimit të Komandantit të FSK-së;
 - (23) emëron gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit dhe mund të shkarkojë Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
 - (24) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - (25) emëron, riemëron, shkarkon dhe liron nga detyra gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - (26) emëron, ri-emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Dhomës së Posaçme me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - (27) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit nga radhët e Prokurorëve, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
 - (28) emëron, riemëron, shkarkon dhe liron nga detyra prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
 - (29) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
 - (30) me propozimin e Qeverisë, emëron, shkarkon, tërheq, liron nga detyra Shefat e Misioneve;
 - (31) emëron dhe shkarkon Guvernatorin dhe anëtarët jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore;
 - (32) i propozon Kuvendit emërimin apo shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës;
 - (33) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli, si dhe emëron anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pas njoftimit nga grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
 - (34) ndërprejnë mandatin e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
 - (35) me propozim të Kryeministrit, cakton përfaqësuesin e autorizuar të ekzekutojë dhe depozitojë në Fondin Monetar Ndërkombëtarë, në emër të Kosovës, një instrument të pjesëmarrjes;
 - (36) me propozim të Kryeministrit, cakton përfaqësues të autorizuar për të nënshkruar në emër të Kosovës, dokumentet origjinale të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtarë, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim,

- Korporatës Financiare Ndërkombëtare dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, Konventës për themelimin e Agjencisë për garantimin e investimeve multilaterale dhe Konventës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera dhe të ekzekutojë e të depozitojë çfarëdo instrumenti të pranimit, instrumentin e ratifikimit, si dhe dokumenteve të tjera që mund të kërkohen për pranimin e anëtarësimit në këto organizata;
- (37) në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; si dhe kur ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij. Në gjendje të jashtëzakonshme, Shtabi i Përgjithshëm vepron si Shtab për Komandantin Suprem;
- (38) miraton planet operationale për gjendjen e jashtëzakonshme sipas propozimeve të Komandantit të FSK-së;
- (39) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme. Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me Presidenten;
- (40) ka të drejtë të kërkojë këshilla nga Këshilli i Sigurisë;
- (41) bashkëpunon me Këshillin e Sigurisë dhe Qeverinë, për të përgatitë, Strategjinë e Sigurisë për Republikën e Kosovës;
- (42) konsultohet për Platformën Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë, para se të dorëzohet për miratim në Qeveri;
- (43) Presidentja dhe Kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën. Kryeministri këshillohet me Presidenten mbi çështjet e Inteligjencës;
- (44) ka kompetencë që të miratojë stemën e FSK-së, emblemat e njërive, dukjen e gradave dhe uniformave të FSK-së, pas propozimit fillestar nga KOMFSK, përmes Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes i cili konsultohet me Kryeministrin;
- (45) ka kompetenca të urdhërojë mobilizimin e FSK-së në rastet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme;
- (46) pas miratimit nga Kuvendi, autorizon dërgimin e FSK-së jashtë vendit, për pjesëmarrje në operationet ndërkombëtare të paqes;
- (47) pas marrjes së vendimit nga Qeveria, autorizon dërgimin e FSK-së për pjesëmarrje në operationet ndërkombëtare humanitare;
- (48) në rrethana të jashtëzakonshme, merr vendim për tërheqjen e personelit të FSK-së nga misioni;
- (49) pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, urdhëron mobilizimin e pjesëtarëve rezervë të FSK-së;
- (50) i dërgohet i njëjti raport që i dërgohet Komisionit përkatës parlamentar për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë nga Ministri i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandanti i FSK-së;

- (51) kërkon përgjegjësi nga Komandanti i FSK-së për mbikëqyrjen dhe sigurimin e ekzekutimit të të gjithë urdhrave të ligjshëm sipas udhëzimeve të Presidentes;
- (52) sipas kërkesës për konsultim nga Kryeministri, merr pjesë në përcaktimin dhe modifikimin e strukturës së FSK-së, e cila i nënshtrohet konfirmimit nga ana e Kuvendit;
- (53) pas konsultimit me Kryeministrin, vendos të hap, riorganizojë dhe të mbyllë misione diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës në vendet e tjera ose organizatat ndërkombëtare, ose zyra përkatëse me qëllim të përfaqësimit të Republikës së Kosovës;
- (54) me propozimin e Qeverisë, miraton gradën diplomatike ambasador;
- (55) akrediton ambasadorët e huaj si përfaqësues të Kreut të Shtetit të tyre dhe pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
- (56) aprovon hapjen e një përfaqësie të re diplomatike të huaj;
- (57) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me Ligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti, duke përfshirë edhe ndarjen e dekoratave, medaljeve dhe mirënjohjeve për shërbim meritore dhe veprat e trimërisë nga ana e pjesëtarëve të FSK-së;
- (58) konsultohet nga Qeveria gjatë përcaktimit të ditëve memoriale;
- (59) shpall falje individuale për personat e dënuar për vepra penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata;
- (60) jep shtetësinë e Republikës së Kosovës, në rastet e përcaktuara me ligj;
- (61) për të vënë në pah dallimin dhe identifikimin e saj, ka të drejtë në flamur dallues;
- (62) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit përkitazi me fushë veprimtarinë e saj.